

**MEHMET PASHË DERALLA DHE MISIONI I
PAPËRFUNDUAR
I LUFTËS PËR ÇLIRIM DHE BASHKIM KOMBËTAR
Abdulla MEHMETI**

UDK: 94:323.1(496.5:=18)"18"

Abstrakt

Shekulli XIX karakterizohet me ndërgjegjësimin e kombeve të Gadishullit Ilirik për krijimin e shteteve të tyre kombëtare, të cilët, kush më herët e kush më vonë, ia arritën këtij qëllimi, kryesisht përmes kryengritjeve të armatosura dhe luftërave për çlirim kombëtar nga zgjedha e Perandorisë Osmane.

Kombi shqiptar, i cili ishte ngritur ndër të parët në luftë kundër robërisë pesëshekullore, edhe pse organizoi kryengritjen e Dervish Carës, që në gjysmën e parë të shekullit XIX, e cila i parapriu periudhës së lavdishme të Rilindjes Kombëtare, përmes një vale të madhe të kryengritjeve të njëpasnjëshme, nga Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës dhe sidomos Kryengritjet e përgjithshme të viteve 1910 dhe 1911, mezi arriti ta sigurojë mëvetësinë dhe ta shpall Pavarësinë e Shtetit Shqiptar, më 1912.

Mehmet Pashë Deralla ishte njëri nga prijësit e kryengritjeve të fundit për çlirim dhe bashkim kombëtar, në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ai ishte personaliteti më i shquar i cili e trashëgoi flakadanin e luftës për liri kombëtare nga vendësi i tij Dervish Cara, i cili e tronditi diplomacinë e atëhershme evropiane, me kryengritjen e tij nga më të mëdhatë në historinë e popullit shqiptar, pas Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Gjenerali nga Tetova, Mehmet Pashë Deralla, u zgjodh Ministër i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit, dhe njihet si themelues i Ushtrisë

Shqiptare, si formacion i rregullt ushtarak në mbrojtje jo vetëm të pavarësisë së Shtetit Shqiptar, por edhe të tërësisë territoriale ku jetonin shqiptarët si popull autokton dhe me shumicë në hapësirat gjeografike kompakte në Gadishullin Ilirik.

Rrethanat e mëvonshme, Luftërat Ballkanike, dy Luftërat Botërore, si dhe periudha e regjimit komunist në Shqipëri, Kosovë dhe viset e tjera shqiptare të mbetura nën okupimin e mëtejshëm të shteteve fqinje, dëshmuar se lufta e popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar do të vazhdojë edhe më tej, deri në arritjen e qëllimit përfundimtar, çlirimin e plotë të të gjitha territoreve shqiptare të ndara padrejtësisht nga trangu i shtetit të tyre kombëtar.

Fjalë kyçe: Mehmet Pashë Deralla, gjeneral, kryengritje, çlirim, bashkim, Perandoria Osmane, Kryengritja e Drvish Carës, Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës, Tetova, Shkupi, Stambolli, Vlora, Pavarësia, Shteti Shqiptar, Ushtria Shqiptare.

Çdo përvjetor i shpalljes së Pavarësisë, na kthen në të kaluarën e lavdishme, plot qëndresë dhe fitore, por e përcjellë edhe me tragjedi të mëdha kombëtare.

Shënimi i tetëdhjetë vjetorit të Pavarësisë, më 1992, krijoi rrethana të reja për një zgjim të ri, sidomos të inteligjencies shqiptare dhe studiuesve, për rishikimin e kësaj historie, e cila, edhe pas gati një shekulli, kishte lënë pas vetes po aq tragjedi e dhembje të reja ndër shqiptarët. Edhe pas gati një shekulli nuk kishin pse t'i gëzohen shqiptarët kësaj pavarësie, kur nën thundrën gjakatare të shteteve fqinje ende dergjeshin të përgjakura pjesa më e madhe trojeve shqiptare të mbetura nën okupimin e egër të tyre, ndërsa shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, Luginës së Preshevës, Pazarit të Ri, Ulqini e Tivari me Malësinë e Madhe, Çamërisë dhe viseve të tjera ende vazhdonin luftën e tyre për çlirim dhe bashkim,

ndërsa disa nga këto vise mezi po e mbanin gjallë frymën e qenësisë shqiptare.

Para plot 22 vjetësh, kur po i gëzoheshim përvjetorit të 80-të të kësaj Pavarësie, për herë të parë u krijuan mundësitë të ulemi bashkë, shqiptarë të andej dhe këndej kufirit, që përgjakshëm na mbajti të ndarë për më shumë se gjysmë shekulli. Ishte koha kur lëvizjet e reja demokratike kërkonin ta sigurojnë rrugën e tyre për të ardhmen, dhe kjo nuk mund të bëhej pa iu kthyer rishtas historisë sonë të lavdishme, për ta shikuar edhe një herë këtë mësuese të madhe të jetës dhe, mundësisht, për të ndërmarrë diçka për përmirësimin e gabimeve që kishin bërë të parët tanë, me apo pa fajin e tyre, që edhe nëse nuk do të arrinim t'i përmirësojmë ato gabime, së paku t'i pakësojmë ato, dhe me këtë t'i zbutim dhembjet dhe plagët që ende kullonin gjak.

Në këtë përvjetor, u organizuam për të parën herë studiues e veprimtarë, që, mes tjerash, t'i rikujtojmë dhe rishikojmë disa ngjarje dhe personalitete, në mbështetje të dokumenteve dhe të dhënave historike, sidomos disa nga figurat e rëndësishme kombëtare, si Dervish Cara^[294] dhe Mehmet Pashë Deralla²⁹⁵, të cilët ishin lënë në harresë.

Edhe sot, në 102 vjetorin e Pavarësisë, jemi mbledhur për të njëjtin qëllim, që ta diskutojmë edhe njëherë se cilat ishin arsyet e kësaj harrese dhe cilat janë shkaqet që i lanë shqiptarët të katandisur.

Shekulli XIX karakterizohet me ndërgjegjësimin e kombeve të Gadishullit Ilirik, të cilat, kush më herët e kush më vonë, ia arritën këtij

²⁹⁴ Aleksandar Matkovski, Kryengritja e Dervish Carës, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1985.

²⁹⁵ Zeqirja Idrizi, Mehmet Pashë Derralla - Ministri i Parë i Ushtrisë Kombëtare, **Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike**, 28–29, 1998-1999. f. 167-182, Prishtinë.

qëllimi, për krijimin e shteteve të tyre kombëtare, kryesisht përmes kryengritjeve të armatosura dhe luftërave për çlirim kombëtar nga zgjedha e Perandorisë Osmane. Me krijimin e këtyre shteteve të reja, të cilat kufizoheshin me tokat shqiptare, filluan njëherësh edhe të ngjallen apetitet e tyre për dominim, hegjemoni dhe pushtim të tyre, ndërsa këtyre apetiteve të tyre u vinin në ndihmë fuqitë e mëdha evropiane të asaj kohe dhe Rusia, ja pse mund të supozojmë pse shqiptarët me shumicë i takonin besimit islam, që mund të trajtoheshin si aleatë të natyrshëm të ringjalljes së Perandorisë Osmane, por më tepër duke i vënë në plan të parë interesat e tyre strategjike dhe duke u përpjekur për krijimin e aleancave të reja, që sipas tyre do të ishin në interes afatgjatë për stabilizimin e gjendjes në këto hapësira të trazuara nga luftërat dhe kryengritjet. Shqiptarët për të satën herë e kishin dëshmuar se janë pjesë e pandarë e qytetërimit evropian, se i kanë dhënë Evropës së asaj kohe më tepër seç kishin mundur.

Populli shqiptar, i cili ishte ngritur ndër të parët në luftë kundër robërisë pesëshekullore, edhe pse organizoi kryengritjen e Dervish Carës, që në gjysmën e parë të shekullit XIX, e cila i parapriu periudhës së lavdishme të Rilindjes Kombëtare[296], përmes një vale të madhe të kryengritjeve të njëpasnjëshme, nga Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës dhe sidomos Kryengritjet e përgjithshme të viteve 1910 dhe 1911, mezi arriti ta sigurojë mëvetësinë dhe ta shpall Pavarësinë e Shtetit Shqiptar, më 1912. Sapo kishin filluar t'i lëkundën pozicionet e Perandorisë Osmane[297], më 1878, në Kongresin e Berlinit, tringut shqiptar iu amputuan pjesë shumë vitale të tij, duke ua dhënë Fuqitë e mëdha në tavolinë diplomatike, Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, ndërsa një vit pas shpalljes së Pavarësisë, në Kongresin e Berlinit, po këtyre shteteve

²⁹⁶ Vebi Xhemaili, Dervish Cara -Tetova kërkoi autonominë e Shqipërisë para 170 vjetësh, Bota Sot, 05.10.2014.

²⁹⁷ Vebi Xhemaili, Shqiptarët e Maqedonisë së sotme nga Kryengritja e Derrvish Carës 1843 deri te kryengritja e Dibrës 1813, Tetovë 2014, f. 43-51.

fqinje, Fuqitë e mëdha ua hapën rrugën e pushtimeve të reja të tokave shqiptare.

Gjatë sundimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane²⁹⁸, shqiptarët kishin arritur ta ruajnë në një formë tërësinë territoriale në korniza të katër vilajeteve, por nga këtu buroi e keqja e brendshme për shqiptarët, krahas së keqes që u vinte nga fqinjët. Ndasitë në baza krahinore filluan ta brejnë nga brenda qenien kombëtare. Lufta dhe rivaliteti mes tyre, interesat personale e fisnore dhe nxitjet nga jashtë, shpesh kishin përfunduar në konflikte të hapura mes vetë shqiptarëve dhe shpeshherë duke rënë pre e shteteve fqinje, sidomos të Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat asnjëherë nuk i kanë fshehur synimet e tyre për pushtimin e tokave shqiptare dhe daljen në Detin Adriatik dhe atë Jon.

Edhe sot mbetet për t'u diskutuar së paku disa çështje në lidhje me këtë, si:

1. Cilat ishin arsyet që u la në harresë Ministri i parë i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit më 1912, Mehmet Pashë Deralla, i cili bashkë me babën Hasanin dhe me djemtë e tij, më vonë, për një çerek shekulli luftuan cep më cep të Shqipërisë për çlirim dhe bashkim kombëtar?

2. Pse u krijuan mospajtimet fetare dhe krahinore pikërisht pas shpalljes së Pavarësisë dhe u hapën dyert për infiltrimin e elementeve serbe dhe greke, jo vetëm në territoret shqiptare të mbetura edhe më tej nën okupim, por edhe brenda Shtetit Shqiptar?

3. Si ndodhi që edhe pas gati një shekulli të Shtetit Shqiptar, historia po përsëritej dhimbshëm, sa herë që Kosova ngrihej për t'i shkëputur përfundimisht zinxhirët e robërisë nga regjimi serb, qarqe të

²⁹⁸ Hamer, J, Osmansko Carstvo, Vëll. III, Zagreb, 1980.

ndryshme brenda Shtetit Shqiptar sajnin trazira me përmasa të përgjakshme, me të vetmin qëllim pamundësimin e shqiptarëve të flasin me një zë dhe luftojnë në një front kundër armiqve shekullorë?

4. Cilat ishin arsytet që përveç se u la në harresë figura e Mehmet Pashë Derallës, ministrit të vetëm që përfaqësonte Kosovën dhe viset e tjera shqiptare të mbetura jashtë kufirit administrativ të Shqipërisë, të retushohen dhe falsifikohen edhe ato pak dëshmi të shkruara dhe fotografi të mbetura nga akti i shpalljes së Pavarësisë në Vlorë?

5. Si arritën për një shekull me radhë, edhe pas krijimit të Shtetit Shqiptar, gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe përpjekjeve të fundshekullit XX, në Kosovë dhe vise të tjera shqiptare, armiq të e përbetuar të kombit tonë, serbët dhe grekët, ta shtrijnë ndikimin tyre në çdo pore të lëvizjeve tona politike, në ekonomi, politikë, kulturë, diplomaci dhe në të gjitha sferat e tjera, duke i përçarë shqiptarët në baza krahinore, fetare dhe politike. Kjo fatkeqësisht do të vazhdojë edhe sot, pas 102 vjet pavarësi?

6. Si arriti Serbia, përkatësisht komunistët jugosllavë ta bashkëthemelojnë Partinë Komuniste Shqiptare dhe gjatë gjithë periudhës së luftës t'i përçajnë shqiptarët dhe t'i detyrojnë të vriten mes tyre, në mënyrë të pakuptueshme. Dhe, çuditërisht, ndikim të njëjtë, me një dorë fine të kontrollit nga brenda, do t'i mbajnë edhe disa nga lëvizjet e mëvonshme politike të shqiptarëve, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe vise të tjera?

Përfundim

Mehmet Pashë Deralla ishte njëri nga prijësit më të shquar të kryengritjeve të fundit për çlirim dhe bashkim kombëtar, në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ai ishte personaliteti më i shquar që trashëgoi flakadanin e luftës për liri kombëtare nga vendësi i tij Dervish Cara, i cili e tronditi diplomacinë evropiane të asaj kohe me kryengritjen e tij nga më të mëdhatë në historinë e popullit shqiptar, pas Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Gjenerali nga Tetova, Mehmet Pashë Deralla, u zgjodh Ministër i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit dhe njihet si themelues i Ushtrisë Shqiptare, si formacion i rregullt ushtarak në mbrojtje jo vetëm të pavarësisë së Shtetit Shqiptar, por edhe të tërësisë territoriale ku jetonin shqiptarët në hapësirat e Gadishullit Ilirik, në një sipërfaqe trefish më të madhe nga kjo që sot e ka Shqipëria si shtet.

Rrethanat e mëvonshme, Luftërat Ballkanike, dy Luftërat Botërore, si dhe periudha e regjimit komunist në Shqipëri, Kosovë dhe viset e tjera shqiptare të mbetura nën okupimin nga shtetet fqinje, dëshmuar se lufta e popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar do të vazhdojë edhe më tej, deri në arritjen e qëllimit përfundimtar, çlirimin e plotë të territoreve shqiptare të ndara padrejtësisht nga trangu i shtetit kombëtar.

Bibliografia

-Aleksandar Matkovski, Kryengritja e Dervish Carës, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1985.

-Zeqirja Idrizi, Mehmet Pashë Deralla - Ministri i Parë i Ushtrisë Kombëtare, Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike, 28-29, 1998-1999. f. 167-182, Prishtinë.

-Vebi Xhemaili, Dervish Cara -Tetova kërkoi autonominë e Shqipërisë para 170 vjetësh, Bota Sot, 05.10.2014.

-Vebi Xhemaili, Shqiptarët e Maqedonisë së sotme nga Kryengritja e Derrvish Carës 1843 deri te kryengritja e Dibrës 1813, Tetovë 2014, f. 43-51.

-Hamer, J, Osmansko Carstvo, Vëll. III, Zagreb,1980.